



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2018

Relacion mbi miratimin e tarifës së shoqërisë ALBGAS sh.a si operator i transmetimit të gazit natyror, për vitin 2018

Me shkresën Nr. 85/1 Prot dt. 3 Janar 2018 (protokolluar në ERE me Nr. 13 Prot. dt. 4 Janar 2018), ALBGAS sh.a, dërgoi “Kërkesën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror”, sipas materialit që shoqëria i ka bashkangjitur kësaj shkrese.

Bordi e ERE-s, me Vendimin Nr. 20, Datë 19.01.2018 vendosi “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAS sh.a, për vitin 2018”

Më tej ERE, me anë të shkresës 13/1 Prot, datë 26.01.2018, pas analizës së kryer këtij aplikimi I kërkoi ALBGAS sh.a. dokumentacion plotësues lidhur me kostot e paraqitura në këtë shkresë, për të mundësuar një vendimarrje sa më të drejtë në llogaritjen e kostove që I përkasin ALBGAS sh.a në ushtimin e aktivitetit të transmetimit të gazit natyror për vitin 2018.

Në vijim pas marrjes së vendimit Nr.20, datë 19.01.2018 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAS sh.a, për vitin 2018”, kemi vijuar me publikimin e aplikimit të paraqitur nga ALBGAS sh.a. si dhe të gjithë dokumentacionit plotësues të dërguar me shkresën nr.13/3, Prot., datë 20.02.2018

Pas analizës së përgjigjeve të dërguara nga shoqëria u zhvillua një seancë teknike në datë 20.03.2018 me përfaqësuesit e ALBGAS sh.a. dhe Albpetrol sh.a. Në seancën teknike u diskutuan çështjet e paqartësuar, në lidhje me analizën e kryer të aplikimit në vetvete, përgjigjeve shtesë të dërguara nga shoqëria si dhe trajtimet teorike të Metodologjisë përkatëse për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror. Në përfundim të seancës, u ra dakord që të dergoheshin në ERE sqarime të mëtejshme për komponentët e ndyshëm të të ardhurave të kërkuara për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018.

Në vijim, ALBGAS sh.a. dërgoi në adresën zyrtare të ERE-s shpjegime shtesë mbi aplikimin për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018 me emailin e datën 27.03.2018, ku pas analizës së tyre u organizua përsëri një séance dëgjimore me datë **30.03.2018** për të gjitha palët e interesuara në këtë proces, në të cilën mungoi pjesëmarrja e Albpetrol, megjithëse u njoftua me shkresën 13/8, datë 28.03.2018 dhe me emailin e datës 28.03.2018 për këtë seancë. Kjo séance u bë dhe në prani të mediave vizive.

Deri në këtë kohë nuk patëm asnjë opinion nga palët e interesuara e për me teper nga Albpetrol sh.a. në lidhje me tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018, të propozuar nga ALBGAS sh.a.

Ne vijim te ketij procesi me date 16.04.2018 me urdhrin nr. 33, datë 06.04.2018, u organizua perseri nje séance degjimore publike ku moren pjese nga palet e interesuara Albpetrol sh.a. dhe Autoriteti i Konkurences.

Sqarojme se ne kete séance Albpetrol sha ,si perdoruesi kryesor I rrjetit te transmetimit te gazit natyror, shprehu opinionin ne lidhje me reduktimin e disa shpenzimeve operative te parashikuara per aktivitetin e transmetimit , nisur nga eksperiencia e vitetve te mepareshme kur ky aktivitet ishte ne administrim te kesaj kompanie.

Ne perfundim te ketij procesi, pas analizave te bera nga ana jone te aplikimit te paraqitur nga shoqeria Albgaz sh.a si dhe materialeve plotesuese si dhe shpjegime te marra pergjate te gjithë seancave teknike dhe joteknike si dhe asaj publike, po paraqesim analizen tone ne lidhje me kostot e aktivitetit te transmetimit te gazit Natyror per vitin periudhen 01.04.2018 -31.12.2018, si me poshte:

Aplikimi për tarifë është paraqitur në formë të përmbledhur ku evidontohet historiku i shoqërisë dhe përgjegjësitë kryesore të saj të cilat burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe ato rregullatore në fuqi si operatori përgjegjës për transmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria "ALBGAZ sh.a", ushtron aktivitetin si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror në Shqipëri, në zbatim të VKM Nr. 848, datë 07.12 2016 për *"Krijimin e Shoqërisë Albgaz sh.a dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të shoqërisë Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a"*.

Bordi i ERE-s:

- me Vendimin Nr. 188, datë 10.11.2017, ka liçensuar shoqërinë Albgaz sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të gazit natyror.
- me Vendimin Nr. 179, datë 08.11.2017 ka Çertifikuar shoqërinë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, ALBGAZ” sh.a.
- me Vendimin, Nr. 90, datë 07.06.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017”
- me Vendimin Nr. 155, datë 28.09.2017 u vendos mbi Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017–20.09.2017” deri në 31.12.2017.
- me Vendimin Nr. 178, datë 08.11.2017, ka miratuar Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
- me Vendimin Nr. 14 datë 10.01.2018 është vendosur për shtyrjen e afatit të tarifës së përkohëshme të transmetimit për shoqërinë ALBGAZ sh.a. deri në datë 31.03.2018, si dhe mbi shtyrjen e afatit të kontratës së transmetimit të gazit natyror të lidhur mes Albpetrol sh.a. dhe ALBGAZ sh.a. të miratuar për të vënë në dukje që shoqëria ka vijuar dhe do të vijojë deri në datë 31.03.2018 të ushtrijë aktivitetin e transmetimit (sipas kësaj kontrate) me tarifën e përkohshme të miratuar dhe shtyrë nga ERE.
- me Vendimin Nr. 20, Datë 19.01.2018 filloi procedurën për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a, për vitin 2018

Në këtë Aplikim Albgaz sh.a. sqaron se ka hartuar Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018 si dhe për 3 (tre) vjeçarin e ardhshëm 2018 – 2021 në përputhje me objektivat e përcaktuara nga organet drejtuese në zbatim të Udhëzimit Nr.394, Datë 21.08.2014 “*Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërive Tregëtare me Kapital Shtetëror*”. (I dërguar me dokumentacionin plotësues)

Shoqëria parashtron vështirësitë me të cilat ajo ballafaqohet në përmbushjen e objektivave të saj siç janë ato:

- kostot e rrjetit,
- parashikimin e kostove të përgjithshme të shoqërisë për vitet në vijim
- përcaktimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror, për shkak të mungesës së të dhënave historike të këtij sektori të cilat e bëjnë të pamundur zbatimin në tërësi të “*Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*” miratuar me Vendimin Nr.178, datë 08.11.2017 të Bordit të ERE-s.

Gazifikimi i Shqipërisë është një koncept i ri dhe parashikimi i kostove është i bazuar në parim në Planin e Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë, i cili nuk ka baza historike.

Shoqëria kërkon që, me qëllim sigurimin e vazhdimësinë normale të procesit të punës, duke u bazuar në Vendimin Nr.155, datë 28.09.2017 “*Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017” deri në 31.12.2017*”, ku efektet e tarifës së përkohshme kanë patur vlefshmërinë deri më 31.12.2017 dhe në vazhdimësi për vitin 2018, tarifa e transmetimit të gazit natyror të jetë **40 lekë/m³**.

Mbas analizës së kryer aplikimit për tarifë, dokumentacionit plotësues dhe sqarimeve shtesë, po paraqesim analizën e kostove të rrjetit (direkte dhe indirekte) dhe kostot kapitale, për përcaktimin e të ardhurave të kërkuara, me qëllim llogaritjen e tarifës së transmetimit të gazit natyror të ALBGAZ sh.a për vitin 2018:

1. Kërkesa e të ardhurave të kërkuara e paraqitur në aplikimin e datës 03.01.2018:

| *ANALIZA E KOSTOVE PER CAKTIMIN E TARIFES SE TRANSMETIMIT TE GAZIT NATYROR | | |
|---|------------------|--------------------------------|
| Emertimi | Njësia | Kosto Operacionale 2018 |
| Kosto Page | 000/Lekë | 45,757 |
| Trajtime | 000/Lekë | 3,000 |
| Sigurimet shoqerore | 000/Lekë | 7,641 |
| Te tjera konstante | 000/Lekë | 200 |
| Lubrifikant-Karburant | 000/Lekë | 3,500 |
| Energji elektrike | 000/Lekë | 9,000 |
| Shpenz Marteriale + veshje pune | 000/Lekë | 5,500 |
| Shpen.zhdemtim mjedisi- vl mjedisor | 000/Lekë | 1,800 |
| Humbje 000/Leke | 000/Lekë | 1,400 |
| | 000/Lekë | |
| C (Elementet e Kostots sipas Nenit 7) | 000/Lekë | 77,798 |
| D (Amortizimi sipas percaktimit Neni 8) | 000/Lekë | 11,500 |
| ROC (Kthimi mbi kapitalin sipas Nenit 10) | 000/Lekë | 55,142 |
| CRI (Te ardhura te zbritshme sipas Nenit 11) | 000/Lekë | - |
| OCP (Axxhustime sipas Nenit 12) | 000/Lekë | - |
| CG (Grant Tap AG) | 000/Lekë | |
| GC = C + D + ROC - CRI + OPC | 000/Lekë | 144,440 |
| Sasia e Transmetuar | (000/NM3) | 3,611 |
| | | |
| Tarifa e Transmetimit | Lekë/m3 | 40 |

- Në vijimi të kërkesës tone për plotësim dokumentacioni me anë të shkresës 13/1 Prot, datë 26.01.2018, ALBGAZ sh.a. dërgoi në ERE të ardhurat e kërkuara të rrillogaritura për vitin 2018 si rezultat I alokimit më të saktë të kostove për aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjs së gazit natyror, të cilën e paraqesim më poshtë krahas dhe realizimit faktik për periudhën ushtrimore të mbyllur 2017:

| ANALIZA E KOSTOVE PER CAKTIMIN E TARIFES SE TRANSMETIMIT TE GAZIT NATYROR | | | |
|---|------------------|----------------------------------|-------------------------|
| Emertimi | Njësia | Kosto Operacionale realizim 2017 | Kosto Operacionale 2018 |
| Kosto Page | 000/Lekë | 25,663 | 39,156 |
| Trajtime | 000/Lekë | 8,005 | 10,356 |
| Sigurimet shoqerore | 000/Lekë | 4,281 | 6,427 |
| Te tjera konstante | 000/Lekë | - | 200 |
| Projekti per sigurimin teknik enesh nen presion | 000/Lekë | 988 | |
| Lubrifikant-Karburant | 000/Lekë | 1,733 | 3,500 |
| Energji elektrike | 000/Lekë | 6,865 | 9,000 |
| Shpenz Marteriale + veshje pune | 000/Lekë | 75 | 5,500 |
| Shpen.zhdemtim mjedisi- vl mjedisor | 000/Lekë | - | 1,800 |
| Humbje 000/Leke | 000/Lekë | 79 | 1,400 |
| C (Elementet e Kostots sipas Nenit 7) | 000/Lekë | 47,689 | 77,339 |
| D (Amortizimi sipas percaktimit Neni 8) | 000/Lekë | 2,000 | 11,500 |
| ROC (Kthimi mbi kapitalin sipas Nenit 10) | 000/Lekë | 28,677 | 28,677 |
| CRI (Te ardhura te zbritshme sipas Nenit 11) | 000/Lekë | - | - |
| OCP (Axxhustime sipas Nenit 12) | 000/Lekë | - | 19,662 |
| GC = C + D + ROC -CRI + OPC | 000/Lekë | 78,366 | 137,178 |
| Sasia e Transmetuar | (000/NM3) | 767 | 3,611 |
| Tarifa e Transmetimit | Lekë/m3 | 102 | 38 |

3. Pas seancës dëgjimore publike, iu la detyrë Albgaz sh.a. të sqarojë dhe një here komponentët e të ardhurave të kërkuara: RAB, investimet e reja, kapitalin e punës si dhe përlllogaritjen e axhustimit të periudhës së mëparshme rregullatore, etj, të cilat Shoqëria e paraqiti sipas tabelës së mëposhtme:

| Elemente kosto | Emertimi | | Kosto Operacionale realizim 2017 | Kosto Operacionale programim 2018 |
|----------------|---|-----------------|----------------------------------|-----------------------------------|
| 1 | Kosto Page | 000/Leke | 25,633 | 39,156 |
| 2 | Trajtime (+ Antidota) | 000/Leke | 8,005 | 10,356 |
| 3 | Sigurimet shoqerore | 000/Leke | 4,281 | 6,427 |
| 4 | Mirembajtje nga te Tretet | 000/Leke | | 7,000 |
| 5 | Projekti per sigurim teknik enesh nen presion | 000/Leke | 988 | |
| 6 | Shpenzime Qeraje | 000/Leke | | 5,000 |
| 7 | Lubrifikant-Karburant etj | 000/Leke | 1,733 | 2,417 |
| 8 | Energji elektrike | 000/Leke | 6,865 | 9,000 |
| 9 | Shpenz Marteriale etj | 000/Leke | 75 | 3,351 |
| 10 | Shpen.zhdemtim mjedisi- vl mjedisor | 000/Leke | | 1,500 |
| 11 | Projektim Magazina + Zyrrat Fier | | | 2,000 |
| 12 | Trajnim Stafi | | | 10,500 |
| 13 | Humbje | 000/Leke | 79 | 622 |
| C | (Elementet e Kostots sipas Nenit 7) | 000/Leke | 47,659 | 97,329 |
| D | (Amortizimi sipas percaktimit Neni 8) | 000/Leke | 1,820 | 1,788 |
| ROC | (Kthimi mbi kapitalin sipas Nenit 9) | 000/Leke | 31,135 | 36,132 |
| CRI | (Te ardhura te zbritshme sipas Nenit 10) | 000/Leke | - | (55,172) |
| OCP | (Axxhustime sipas Nenit 11) | 000/Leke | - | 20,454.84 |
| | GC = C + D + ROC -CRI + OPC | 000/Leke | 80,614 | 100,532 |
| | Sasia e Transmetuar (1000 / NM3) | | 767 | 2,651 |
| | Tarifa e Transmetimit | | 105 | 38 |

4. Mbas analizës së rillogaritjeve sa më sipër, nga diskutimet përgjatë seancave degjimore teknike dhe publike dhe komunikimeve me stafin e ALBGAZ sh.a., paraqesim paraqesim vlerësimet tona mbi të ardhurat e kërkuara të kompanisë për periudhën rregullatore 2018 dhe variantin përfundimtar të vlerësimit të kostove totale të aktivitetit të transmetimit për si më poshtë:

| Elemente kosto | Emertimi | | Kosto Operacionale realizim 2017 | Kosto Operacionale programim 2018 |
|---|--|-----------------|----------------------------------|-----------------------------------|
| 1 | Kosto Page | 000/Leke | 32,284 | 35,219 |
| 2 | Trajtime | 000/Leke | 8,071 | 8,422 |
| 3 | Antidota | 000/Leke | | 383 |
| 4 | Sigurimet shoqerore | 000/Leke | 5,176 | 5,646 |
| 5 | Mirembajtje nga te Tretet | 000/Leke | - | 4,000 |
| 6 | Shp.per sigurim teknik enesh nen presion | 000/Leke | 998 | |
| 7 | Shpenzime Qeraje | 000/Leke | | 500 |
| 8 | Lubrikant-Karburant etj | 000/Leke | 1,732 | 817 |
| 9 | Energji elektrike | 000/Leke | 6,792 | 6,792 |
| 10 | Shpenz Marteriale etj | 000/Leke | 75 | 2,951 |
| 11 | Te tjera (dieta+kancelari+tel) | 000/Leke | 800 | 400 |
| 12 | Humbje | 000/Leke | 80 | 276 |
| C (Elementet e Kostots sipas Nenit 7) | | 000/Leke | 56,007 | 65,406 |
| D (Amortizimi sipas percaktimit Neni 8) | | 000/Leke | 1,839 | 1,807 |
| ROC (Kthimi mbi kapitalin sipas Nenit 9) | | 000/Leke | 17,592 | 7,019 |
| CRI (Te ardhura te zbritshme sipas Nenit 10) | | 000/Leke | - | - |
| OCPC (Axhustime sipas Nenit 11) | | 000/Leke | - | 18,744 |
| GC = C + D + ROC - CRI + OCPC | | 000/Leke | 75,438 | 74,232 |
| Sasia e Transmetuar (1000 / NM3) | | | 768 | 2,651 |
| Tarifa e Transmetimit | | | 98 | 28 |

Bazuar në Metodologjinë përkatëse, kostot e rrjetit do të llogariten:

$$GCt = Ct + Dt + ROCt - CRI t + OCPCt$$

Ku:

Ct Elementët e koston të vitit

Dt Amortizimi I vitit

ROCt Kthimi mbi asetet

CRI t Të ardhurat e zbritshme të vitit

OCPCt Axhustimet e periudhave të ndryshme në vitin (t)

4.1. Kostot e rrjetit të transmetimit për vitin 2018

ALBGAZ sh.a. deklaron se kostot e rrjetit janë llogaritur bazuar në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018.

Ky program ka marrë në konsideratë kostot e realizuara për vitin 2017 si dhe faktin se Shoqëria filloi të operonte në muajin Shkurt si operator I kombinuar për aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes, fakt I cili sjell dhe diferencën midis kostove faktike të vitit të kaluar dhe atyre të parashikuara për vitin 2018.

Shoqëria deklaron se viti 2018 është viti që parashikon projekte të reja, kryesisht të përqendruara tek mirëmbajtja e rrjetit, në mënyrë që të përballojë volumin e gazit të transmetuar.

Pas rishikimit të këtyre kostove, vlerësimet tona të detajuara paraqiten si më poshtë:

| Zerat e Kostove direkte dhe indirekte për rrjetin e transmetimit | Njesia | 2017 (i saktësuar) | Propozuar ALBGAZ 2018 | Propozuar nga ERE |
|--|-----------------|-----------------------|--------------------------|-------------------|
| Kosto direkte | | 46,604 | 52,621 | 52,621 |
| <i>Shpenzime paga</i> | 000/leke | 32,284 | 35,219.00 | 35,219.00 |
| <i>Trajtime</i> | " | 8,071 | 383.00 | 383.00 |
| <i>Antidota</i> | " | | 8,422.00 | 8,422.00 |
| <i>Sigurimet shoqerore</i> | " | 5,176 | 5,646.00 | 5,646.00 |
| <i>Shpenz Marteriale</i> | " | 1,073 | 2,951 | 2,951 |
| Kosto indirekte | " | - | 7,000 | 4,000 |
| <i>Mirembajtje nga te Tretet</i> | " | - | 7,000 | 4,000 |
| Shpenzime të përgjithshme | " | 9,404 | 13,385 | 8,785 |
| <i>Shpenzime qeraje</i> | " | - | 1,500 | 500 |
| <i>Lubrifikant-Karburant</i> | " | 1,732 | 2,417 | 817 |
| <i>Energji elektrike</i> | " | 6,792 | 6,792 | 6,792 |
| <i>Shpen.zhdemtim mjedisi- vl mjedisor</i> | " | - | - | - |
| <i>Të tjera</i> | " | 800 | 2,400 | 400 |
| <i>Humbjet në rrjet</i> | " | 80 | 276 | 276 |
| Totali OPEX | 000/leke | 56,008 | 73,006 | 65,406 |

Siç vërehet nga tabela elementët e kostos të parashikuara nga Shoqëria për vitin 2018 arrijnë në 65,4 milion lekë nga 56 milion lekë të realizuar për vitin 2017, pra me një rritje prej 17%.

a) **Kosto direkte**

- **Shpenzimet e personelit** për vitin 2018 janë parashikuar me një rritje prej 9% krahasuar me vitin 2017. Per percaktimin e fondit të pages është parashikuar niveli I pages me I larte sipas kategorise per cdo punonjes pas kualifikit te metejshem te tyre, si dhe mbulimi I 10 vendeve vakante ne sistemin e operimit.

Shoqëria parashikon për realizimin e aktivitetit në standartet e kërkuara, së pari trajnimin e stafit, si dhe mbulimin e vendeve vakante, për të mundësuar mirëmbajtjen

e rrjetit me qëllim sigurimin e vazhdueshmërisë së furnizimit me gaz natyror brenda parametrave teknik.

Albgaz sh.a. do të bashkepunojë me TAP AG, duke I ofruar shërbimin e mirëmbajtjes. për linjat e transmetimit të TAP AG në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shpenzimi i alokuar vetëm për aktivitetin e transmetimit rezulton që I korespondon një page mesatare prej 53,362 lekë/muaj (*fond page 35,219,000 / 55 punonjës= 640,000 / 12 muaj*)

- ***Shpenzimet për materiale*** dhe veshje pune janë parashikuar në vlerën 2,9 milion lekë gjate vitit 2018, ku parashikohet te blihen materiale të kërkuara nga drejtoritë teknike. Albgaz sh.a. sqaron se këto materiale janë të natyrës: elektroda te ndryshme, bojra antikorozion, saracineska te diametrave te ndryshem, kushinieta, fallanxha, reduktore, manometra, reostate etj, si dhe veshje pune si size saldimi, maska, uniforma të plota për punëtorët për siguri në punë. Ne lidhje me kete shpenzim shoqeria ka paraqitur, ne materialet shtese te kërkuara, edhe librin e prokurimeve.

b) Kosto indirekte

- ***Shpenzime mirembajtje nga te tretet*** nga Albgaz sh.a. u kërkuar në vlerën 7 milion lekë dhe parashikonin kostot për riparim e makinerive dhe paisjeve te kompresorave si dhe stacioneve të gazit Fier e Ballsh. Mbas kontrollit të llogarive për të dy aktivitetet u saktësua që parashikimi vetëm për aktivitetin e transmetimit për këtë zë të jetë në vlerën 4 milion lekë.

c) Shpenzime të përgjithshme

- ***Shpenzimet për lubrifikant dhe karburant*** u kërkuar në vlerën 2.417 milion lekë dhe parashikonin kostot për blerjen e vajit të kompresorive H100, vaj reduktori si dhe gazoil per shërbimet e tjera të kompresorave. Këto shpenzime për vitin 2018 janë kërkuar në vlerën 2.417 milion lekë nga 1,7 milion lekë të realizuara nga shoqëria për të dy aktivitetet për vitin 2017. Mbas kontrollit të llogarive për të dy aktivitetet u saktësua që parashikimi vetëm për aktivitetin e transmetimit për këtë zë të jetë në vlerën 0.817 milion lekë.
- ***Shpenzime qeraje*** u kërkuar në vlerën 1.5 milion lekë. Me arsyetimin si më sipër nisur nga shpenzimet faktike të 3 mujorit të pare 2018, ky zë është rrillogaritur dhe propozohet në vlerën 0.5 milion lekë

- **Energjia elektrike** është vlera përkatëse e konsumit të energjisë elektrike aktive dhe reaktive, që konsumohet nga kompresorat e gazit në Ballsh

Energji reaktive 334,055 kwh/kvarh me cmim 1.65 leke = 551 mijë leke

Energji 358,678 kwh/kvarh me cmim 17.4 leke/kVh = 6 241 mijë leke

Totali 551+6241= 6,792 mijë leke

Sa më sipër, sqarojmë se këto çmime janë pa TVSH dhe aplikohen nga Albpetrol sh.a. për të tretët me një urdhër të brendshëm sipas shpjegimeve të dhëna në séance.

- **Zëri të tjera** u kërkuan në vlerën 2.4 milion lekë. Nga ndarja e shpenzimeve propozojmë që kjo vletë të 0.4 milion lekë për vitin 2018 sikurse shpjeguar dhe në zërat e kostove më lartë.
- **Shpenzimet për humbjet** në rrjetin e transmetimit të gazit natyror, shoqëria sqaron se ato janë llogaritur në vlerën 1,4 milion lekë.

Mbas rialokimit të kostove të transmetimit dhe rillogaritjeve, si dhe nisur nga volumi i gazit që parashikohet të transmetohet për vitin 2018, ky zë paraqitet si më poshtë:

Volumi i levruar i gazit në rrjetin e transmetimit = sasinë e gazit të transmetuar + volumi i gazit për mbulimin e humbjeve

Atehere volumi i levruar do të jetë $S = 2651 / (1 - 0,04) = 2661 \text{ Nm}^3$

Kosto e humbjeve : $2661 * 0,4\% = 10,65 \text{ Nm}^3 * 26 \text{ leke/Nm}^3 = \mathbf{276,8}$ mijë leke

4.2. Amortizimi

Në llogaritjen e vlerës së amortizimit, është gjykuar si më poshtë:

Nisur nga pasqyrat financiare të Shoqërisë ALBGAS sh.a., janë alokuar asetet për aktivitetin e transmetimit e më tej dhe asetet e aktivitetit të shpërndarjes duke argumentuar se amortizimi për *aktivet e trupëzuara*, të cilat u transferuan nga Albpetrol, është llogaritur me formulën lineare të vlerës historike (të blerjes ose transferimit) duke përdorur normat amortizuese si më poshtë:

- "Ndërtesa" me normë në masën 1.5%.
- "Makinë dhe Pajisje" me normë në masën 2.5%.
- "Pajisje Zyre dhe Informatike" me normë në masën 3%.
- "Ndërtim-instalime-tubacione" me normë 1.5%.

Vlera totale e assteve neto si Albgaz ne momentin e celjes eshte **827,554,030 leke dhe ne fund 2017 eshte 840 758 259 leke**

| Nr | Asetet | Vlera fillestare neto e Aam si Albgaz Totali ne fillim 2017 | Vlera fillestare neto e Aam si Albgaz Totali ne fillim 2018 |
|----|-----------------|---|---|
| | Toka | 139,570,475 | 139,570,475 |
| 1 | Ndertesa | 17,328,491 | 17,106,616 |
| 2 | Tubacionet | 639,594,251 | 638,407,669 |
| 3 | Makineri paisje | 30,911,386 | 30,155,120 |
| 4 | Inv Ekonomik | 149,427 | 15,518,380 |
| | | 827,554,030 | 840,758,259 |

- *Gjendja ne fillim 2017 per RAB sipas % per ndertesa 40% , tubacinet 100 % dhe makineri e paisje 75 % ne tabelen eshte 107 389 247 leke*
- *Amortizim per RAB 1 839 078 leke*
- *Gjendja ne fillim 2018 per RAB sipas % ne tabelen eshte 105 550 169 leke*
- *Amortizim per RAB 1 807 441 leke*

| RAB ne fillim 2017 | Amortiz.sipas % RAB 2017 | RAB ne fillim te vitit 2018 | Amortiz.sipas % RAB 2018 |
|--------------------|--------------------------|-----------------------------|--------------------------|
| 4,885,571 | 87,670 | 4,797,901 | 87,670 |
| 79,650,602 | 1,186,583 | 78,464,019 | 1,168,905 |
| 22,853,074 | 564,825 | 22,288,249 | 550,866 |
| | | | |
| 107,389,247 | 1,839,078 | 105,550,169 | 1,807,441 |

Në përfundim, amortizimi I llogaritur për kostot totale të transmetimit, propozojmë të jetë 1,807 mijë lekë.

4.3. Kthimi mbi Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB)

Kthimi mbi bazën e rregulluar të asetëve të operatorit të rrjetit do të llogaritet sipas formulës:

$$R = RAB \times WACC \text{ RABt}$$

| Nr | EMERTIMET A.A.M | Vlera neto 06.01.17 | Vlera neto 31.12.17 sipas PF |
|----|-----------------------------|------------------------|---------------------------------|
| 1 | Toka | 139,570,475 | 139,570,475 |
| 2 | Ndertesa | 17,328,491 | 17,106,616 |
| 3 | Makineri & Paisje | 30,911,386 | 30,155,120 |
| 4 | Mjete Transporti | 0 | - |
| 5 | Paisje Zyre | 149,427 | 470,548 |
| 6 | Paisje Zyre(TAP) | 0 | 5,712,444 |
| 7 | Paisje Kom.(TAP) | 0 | 8,188,034 |
| 8 | Paisje Zyre (albpetrol) | 0 | 859,040 |
| 9 | Paisje ne magazine | - | 288,315 |
| 10 | Tubacionet+Nd.instal | 639,594,251 | 638,407,669 |
| 11 | Te tjera A.A.M ne konservim | - | - |
| | Shuma 1 | 827,554,030 | 840,758,259 |
| 1 | AAJM | 0 | 2,987,290 |
| | Totali | 827,554,030 | 843,745,549 |

Tabela më sipër pasqyron vlerën totale të asetëve për të dy aktivitetet e shoqërisë ALBGAZ sh.a. sipas pasqyrave financiare për vitin 2017.

Për aktivitetin e transmetimit, vlera e këtyre asetëve paraqitet në tabelën në vijim:

Perlogaritja e Variablit RAB 2018

| Lista e Aseteve Operacionale per Transmetim | | | |
|---|---|-------------------|--------------------|
| Nr | | (L) | (RV) |
| | Godina Qendrore | 8,820,000 | |
| | Stacioni Ballsh | 4,756,579 | |
| | Stacioni Fier | 73,500,000 | |
| | Salla e pompave Cakran | 1,857,000 | |
| | Salla e pompave te ujit | 5,962,500 | |
| | Godina Qendrore | | 2,168,854.80 |
| | Godina e kendit te Kuq Ballsh | | 310,183.20 |
| | Godina e stacioni Ballsh | | 172,324.00 |
| | Godina e stacionit | | 192,207.60 |
| | Magazina qendrore Fier | | 72,906.40 |
| | Zyra e stacionit Fier | | 357,903.60 |
| | Godina e kompresorit | | 20,282.40 |
| | Salla e kompresoreve | | 309,274.80 |
| | Rruge grupi+depo uji | | 551,113.60 |
| | Mur mbrojtës i kompresoreve | | 32,727.60 |
| | Rruge grup | | 41,562.40 |
| | Depo uji | | 39,825.60 |
| | puse uji (4 PUSE) | | 89,835.20 |
| | Rruge pusi | | 438,900.00 |
| | Lidhje teknologjike(skema) | | 5,976,138.00 |
| | Tubacion gazi 6" Ballsh-Usoje1.2km | | 1,171,792.00 |
| | Tubacion gazi 12" Ballsh-Fier 24km | | 31,247,785.00 |
| | Tubacion gazi 10" Ballsh-Drenove 5.5 km | | 14,182,156.00 |
| | Tubacion gazi 12" 3.2 kmFier -Potez | | 10,749,238.00 |
| | Gazndares | | 1,371,414.00 |
| | Ndares gazi | | 685,707.00 |
| | Tubacion uji Ø 4" | | 2,923,551.00 |
| | Zevendesim Tubacion uji kompresor | | 1,261,067.00 |
| | Lidhje teknologjike | | 8,228,483.00 |
| | Lidhje teknologjike | | 639,994.00 |
| | Tubacion magjstral uji Ø KOMP. | | 26,694.00 |
| | Aparat mates gazi | | 154,293.75 |
| | Radiomarres stacioni | | 20,474.25 |
| | Aparat mates gazi | | 31,848.75 |
| | Aparat mates gazi konstant 1000 | | 31,848.75 |
| | Rrjete i lidhjes teknologjike | | 1,868,073.00 |
| | Gaz ndares vertikal | | 272,988.00 |
| | Gaz ndares | | 242,655.75 |
| | Elektromotor 22kw | | 353,478.75 |
| | Transformator | | 39,501.00 |
| | Elektromotor 530 kw | | 189,597.00 |
| | Pompe uji 2AB-5/10 | | 112,862.25 |
| | Pompe vaji kompresori | | 45,144.75 |
| | Panel elektrik 22 kw | | 19,360.50 |
| | Panel elektrik 22 kw | | 19,360.50 |
| | kompresori B2s | | 16,929,227.25 |
| | Ieshues 60A- 6 kw | | 84,645.75 |
| | Seperator | | 507,876.75 |
| | Elektromotor 530 kw | | 189,640.50 |
| | Pompe bu 40 | | 1,066,541.25 |
| | Kontaktor 20A | | 20,315.25 |
| | kontaktor 600 A | | 33,858.75 |
| | Kontaktor 400 A | | 22,572.00 |
| | panel elektrik 22kw | | 32,084.25 |
| | Provigjone | 0 | |
| | Pagesa te Marra ne Avart | 0 | |
| | Llogari te Pagueshme pa | 0 | |
| | Te tjera te Pagueshme | 0 | |
| | | 0 | |
| | Total | 94,896,079 | 105,550,169 |

Për efekt të llogaritjes së kthimit mbi asetet, RAB paraqitet si më poshtë:

| <i>Emertimi</i> | <i>Viti 2018</i> |
|---|--------------------|
| Asetet e Rregulluara në fillim të vitit 2018 | 200,446,248 |
| <i>Shtesa (Investime)</i> | 8,075,000 |
| <i>Amortizimi</i> | (1,807,441) |
| <i>Grant</i> | (44,672,000) |
| <i>Kapitali i Punes (WC)</i> | 6,062,789 |
| Baza e Rregulluar e Aseteve për vitin 2018 | 168,104,596 |

Në lidhje me shtesat për vitin 2018, deklarojmë që kemi reserve për asryes se procesi I miratimit të planit të investimeve nuk ka përfunduar. Shoqëria ka kërkuar kthimin mbi RAB rreth 8 milion lekë, vlerë e cila do ti mundësonte mbulimin e investimeve të parashikuara prej saj për vitin 2018.

Nisur nga fakti se vlera e investimeve nuk është miratuar, propozojmë të merret në konsideratë shifra e paraqitur nga Shoqëria gjatë seancave teknike (8 milion lekë) dhe të axhustohet në periudhën pasardhëse për vlerën e miratuar dhe realizuar në fakt. Ky pranim do ti shërbejë rimëkëmbjes dhe ndërtimit të sistemit të transmetimit të gazit natyror.

4.4. WACC

Per përllogaritjen e WACC është pranuar struktura 100% kapital I vet, nisur nga struktura faktike e kapitalit të Shoqërisë, sipas pasqyrave financiare të vitit 2017 pjesë e dokumentacionit plotësues të aplikimit për tarifën e transmetimit ta gazit natyror për vitin 2018.

Shoqëria deklaron se huaja ne vleren totale prej 147 milion Leke të marra në këste përgjatë 2017 nga Albpetrol sh.a. dhe OST sh.a. është marrë per qëllime të mungesës së likujditetit dhe pa interes.

Si fillim, shoqëria propozoi 10% si kthim të kapitalit të vet, përqindje kjo e cila ishte e paarsyetuar për arsye se kthimi do të rezultonte në vlerën 19 milion lekë e cila përbën rreth 20% të kostove totale të Shoqërisë.

Megjithëse, ALBGAS sh.a. dërgoi informacion në lidhje me WACC e cila përdoret në vendet të ndryshme nga Shoqëritë e transmetimit të gazit natyror, ku varion nga 7 deri 8 % mbi strukturën e kapitalit, ne propozojmë një normë të lejueshme të kthimit mbi kapitalin e vet në nivelin 3,65%, e

cila rezulton nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë në lidhje me obligacionet qeveritare për periudhën 2013-2017 dhe I mundëson Shoqërisë financimin e investimeve për vitin 2018, si dhe kompensimin e një pjesë të humbjes financiare të rezultuar për vitin 2017.

4.5. Axhustimi I perudhës së mëparshme rregullatore

Ashtu sikur se rezulton nga pasqyrat financiare për vitin 2017, shoqëria ka rezultuar me humbje. Faktori kryesor që ka ndikuar në rezultatin negative të shoqërisë, është sasia e transmetuar prej 767 N/m3 nga 2861 N/m3.

Në zbatim të metodologjisë kjo shumë duhet axhustuar në rritje te kostot e periudhave pasardhëse (për tre vitet e ardhme), llogaritjen e së cilës e paraqesim si më poshtë:

| | |
|--|-----------------------------|
| <u><i>Te Ardhurat e lejuara per 2017 (98 lek/Nm3 * 768339 Nm3)</i></u> | <u><i>75,209,110.48</i></u> |
| <u>Te ardhurat per tu axhustuar/korigjuar nga viti 2017 2017 (Te Ardhurat e Lejuara-Te ardhurat aktuale)</u> | <u>56,000,635</u> |
| <u>Te ardhurat per tu axhustuar e alokuar vetem per vitin E MBARTUR PER 2018 (1/3 E OCP)</u> | <u>18,666,878</u> |

Nga rishqyrtimi I shpenzimeve dhe të ardhurave të Albgaz sh.a., si dhe parashikimi që Shoqëria pret të marrë gjatë vitit 2018 financime nga TAP AG, propozojmë që korigjimi I kostove në rritje si pasojë e axhustimeve të periudhës së mëparshme, të mos përfshihet në totalin e kostove të Albgaz sh.a. për vitin 2018.

4.6. Tarifa e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018

Në përfundim totali I koston për mbulimin e aktivitetit të transmetimit të shoqërisë ALBGAZ sh.a. do të paraqitet si më poshtë:

| Zerat e Kostove direkte dhe indirekte për rrjetin e transmetimit | Njesia | 2017 (i saktësuar) | Propozuar ALBGAZ 2018 | Propozuar nga ERE |
|--|-----------------|-----------------------|--------------------------|-------------------|
| Kosto direkte | | 46,604 | 52,621 | 52,621 |
| <i>Shpenzime paga</i> | 000/leke | 32,284 | 35,219.00 | 35,219.00 |
| <i>Trajtime</i> | " | 8,071 | 383.00 | 383.00 |
| <i>Antidota</i> | " | | 8,422.00 | 8,422.00 |
| <i>Sigurimet shoqerore</i> | " | 5,176 | 5,646.00 | 5,646.00 |
| <i>Shpenz Marteriale</i> | " | 1,073 | 2,951 | 2,951 |
| Kosto indirekte | " | - | 7,000 | 4,000 |
| <i>Mirembajtje nga te Tretet</i> | " | - | 7,000 | 4,000 |
| Shpenzime të përgjithshme | " | 9,404 | 13,385 | 8,785 |
| <i>Shpenzime qeraje</i> | " | - | 1,500 | 500 |
| <i>Lubrikant-Karburant</i> | " | 1,732 | 2,417 | 817 |
| <i>Energji elektrike</i> | " | 6,792 | 6,792 | 6,792 |
| <i>Shpen.zhdemtim mjedisi- vl mjedisor</i> | " | - | - | - |
| <i>Të tjera</i> | " | 800 | 2,400 | 400 |
| <i>Humbjet në rrjet</i> | " | 80 | 276 | 276 |
| Totali OPEX | 000/leke | 56,008 | 73,006 | 65,406 |
| Vlera e asetëve | | 204,613 | 200,446 | 200,446 |
| <i>Investime</i> | | | 8,075 | 4,038 |
| <i>Amortizimi</i> | | (1,839) | (1,807) | (1,807) |
| <i>Grant</i> | | (16,228) | (44,672) | (44,672) |
| Vlera neto e Aseteve | 000/leke | 186,546 | 162,042 | 158,005 |
| Kapitali I punes | 000/leke | | 6,083.83 | 5,450.50 |
| Baza e Rregulluar e Aseteve | " | 186,546 | 168,126 | 163,455 |
| ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse | (%) | 8.00% | 4.18% | 3.65% |
| ES - Objektivi per raportin e kapitalit te vet ne RAB | " | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| T - Norma e takses se korporates | " | 15.00% | 15.00% | 15.00% |
| CoD - Kosto e borxhit | " | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| DS - Objektivi per raportin e borxhit ne RAB | " | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| WACC (Weighted Average Cost of Capital) | (%) | 9.41% | 4.91% | 4.29% |
| Kthimi I lejuar mbi RAB | 000/leke | 17,557 | 8,261 | 7,019 |
| Amortizimi I vitit | | 1,839 | 1,807 | 1,807 |
| Axhustim I periudhes se meparshme | | | 18,744 | |
| <i>Axhustim 2018 (Grant per trajnimin e stafit nga TAP AG)</i> | | | | |
| Total I Te Ardhurave te Kerkuara | 000/leke | 75,404 | 101,818 | 74,232 |
| Sasia e gazit per tu transmetuar per vitin 2018 | (000/NM3) | 768 | 2,651 | 2,651 |
| Tarifa mesatare e transmetimit | Lekë/m3 | 98 | 38 | 28 |
| Tarifa mesatare e transmetimit | Lekë/kWh | 9.2771 | 3.6291 | 2.6457 |

Në mbështetje të neneve 13 pika 2, dhe 33 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Neni 19 pika 1 gërma “c” dhe neni 21, 22 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedruave të ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17,06,2016, nisur dhe nga arsyetimet dhe analizën e mësipërme, rezultatin e llogaritjeve përkatëse mbi tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018, I propozojmë Bordit të ERE-s:

- **Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a, për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kWh.**